

## KAMY – I huaji

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

**Ekzistencializmi i Kamysë (dhe Sartrit).**

*Bota e pandryshueshme dhe kaotike, qenia absurde, e trembur, nën tiraninë e frikës, shqetësimit, pikëllimit. Ekzistencializmi predikon lirinë absolute, që sjell vetëdijen individuale dhe lirinë e zgjedhjes.*

**Revolta e individit; përse i shërben ajo atij? Ideja e Kamysë në lidhje me këtë çështje.**

*-Revolta është forcë e brendshme e individit, që i shërben atij për të përballuar absurdin, që nuk e lë këtë ta mposhtë individin, që i jep atij mundësi të ruajë dinjitetin kundër poshtërimit dhe shtypjes.*

*-Sipas Kamysë, revolta s’duhej drejtuar kundër të tjerëve, aq më tepër nuk duhet të synojë pushtetin, për të ushtruar dhunë. Kamy ishte për ruajtjen e statukuosë politike dhe shoqërore, ngaqë kishte bindjen se ndryshimet revolucionare dhe në përgjithësi ndryshimet e dhunshme çojnë vetëm në tragjedi.*

**Duke e ndjekur kronologjikisht veprën e Kamysë, mund të kuptojmë cili është evoluimi krijues i tij (etapat e këtij evoluimi)**

*-Afrimi me të majtët, me Rezistencën antifashiste, revolta për ndryshim, e radikale.  
-Afrimi me të djathtët, protesta kundër revolucioneve e diktaturave, mbrojtja e lirisë absolute të individit.  
-Pesimizmi (novela “Rënia”).*

**Romani “I huaji” është i ndarë në dy pjesë. Cili është ndryshimi midis dy pjesëve?**

-shënime-

Ç'përfaqëson Mersoi? Cila është e keqja nga e cila vuan? Nga buron kjo e keqe? Cili është shpëtimi prej saj?

Cilat janë tri tragjeditë përmes së cilave kalon jeta e Mersoit?

Pse Kamy i përshkruan tragjeditë që i ndodhin Mersoit si gjëra të zakonshme?

Ç'është liria absolute dhe cila është dilema Kamysë për të?

Cili mendoni të jetë thelbi humanist i veprës së Kamysë "I huaji"?  
(mbështetuni tek përgjigjja që i dhatë pyetjes paraardhëse)

Mersoi shpërfill moralin e shoqërisë dhe përfundon i ekzekutuar.

A ka ndonjë përfitim prej kësaj shpërfilljeje që tregon?

Cila është arsyeja që Mersoi dënohet përfundimisht?

-shënime-

Në romanin "I huaji" synimi i Kamysë është të kritikojë shoqërinë dhe mënyrën si është ndërtuar ajo?

Duke pasur parasysh kohën në të cilën u shkrua...  
A është romani "I huaji" një sfidë e Kamysë ndaj fashizmit?

Cili është mesazhi i romanit "I huaji"?

Pse Kamy i ka vënë emrin Merso protagonistit të veprës së tij?

Analizoni titullin e romanit "I huaji".

Analizoni thelbin e Mersoit, shprehur nga Kamy me fjalët: *"Është historia e njeriut, i cili pa qenë hero, pranoi të vdiste për të vërtetën"*.

Çfarë e afron dhe çfarë e largon Kamynë nga ekzistencializmi?

-shënime-

Çfarë të përbashkët dhe çfarë të ndryshme kanë Kafka dhe Kamy?

Kamy –

Kafka -

Në ç'pjesë të romanit "I huaji" fillon e ndihet i huaj Merso?

Cili është roli i diellit në fragmentin e vrasjes së arabit?

Mbani parasysh "*dehjen marramendëse të Mersoit prej diellit*" dhe bëni një koment për kuptimin e fjalive të mëposhtme:

*... masivi shkëmbor, i errët e i mjegulluar, si i mbuluar me një vello verbuese drite e avulli... më shumë më fanitej shëmbëlltyra e arabit në atë ajër të përvëlimentë...*

Cilat janë dy mjediset e përshkruara në paragrafin më poshtë? Çfarë ide japin të përshkruara kështu, ngjitur me njëri-tjetrin?

*Larg u duk masivi shkëmbor, i errët e i mjegulluar, si i mbuluar me një vello verbuese drite e avulli që vinte nga deti. Mendja më shkoi te burimi i freskët që gjendej prapa shkëmbit. Ma kishte ënda ta ndjeja përsëri gurgullimën e ujit, t'i vidhesha diellit, të gjeja përsëri hijen dhe shlodhjen.*

Ku duket që Merso është i huaj edhe për krimin që bën?

-shënime-

**Komentoni mendimin e Mersoit:**

*“Thashë me vete se mjaftonte të kthehesha njëqind e tetëdhjetë gradë dhe çdo gjë do të merrte fund...”*

**Krahasoni Mersoin me arabin.**

Pasi qëllon arabin, Merso mendon:

*“E kuptova se kisha prishur ekuilibrin e ditës”.*

**Për çfarë ekuilibri e ka fjalën?**

**Komentoni fjalinë:**

*Atëherë qëllova dhe katër herë të tjera... Ishin si katër trokitje të shkurtra mbi portën e fatkeqësisë.*